



UNIVERSITETI I PRISHTINËS  
"HASAN PRISHTINA"  
UNIVERSITY OF PRISHTINA

Rr. Xhorxh Bush, Ndërtesa e Rektoratit, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës  
Tel: +381 38 244 183 • E-mail: rektorati@uni-pr.edu • www.uni-pr.edu

Nr. Prot.: 2/177  
Datë: 28/9/2023

Senati i Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina", bazuar në kompetencat e përcaktuara sipas nenit 48 të Statutit të UP-së, në mbledhjen e mbajtur me datë 25.9.2023, mori këtë:

**V E N D I M**

***Për vazhdimin e kohëzgjatjes së afatit për përfundimin e studimeve për studentët e nivelit të studimeve baçelor, master dhe doktoratë, të cilët e kanë kaluar periudhën e lejuar të kohëzgjatjes së rregullt të studimeve***

- I. Studentëve të nivelit baçelor me sistem tre (3) vjeçar, të cilët i kanë regjistruar studimet në vitin akademik 2015/2016, kanë kaluar dyfishin e kohëzgjatjes së rregullt të studimeve, kanë dëgjuar ligjëratat e vitit të fundit, si dhe kanë përfunduar të gjitha provimet e dy (2) viteve paraprake, u vazhdohet periudha e përfundimit të studimeve deri më 30.9.2024.
- II. Studentëve të nivelit baçelor me sistem tre (3) vjeçar, të cilët i kanë regjistruar studimet para vitit akademik 2015/2016, dhe të cilët i kanë përfunduar të gjitha provimet në pogramet që përfundojnë me mbrojtje të punimit të temës së diplomës, u vazhdohet periudha e diplomimit, respektivisht mbrojtjes së punimit të temës së diplomës deri më 30.9.2024, ndërsa në programet që studimet përfundojnë pa punim të diplomës dhe nuk kanë më shumë se dy provime të vitit të fundit, u vazhdohet periudha e përfundimit të studimeve deri më 30.9.2024.
- III. Studentëve të nivelit baçelor me sistem katër (4) vjeçar, të cilët i kanë regjistruar studimet në vitin akademik 2013/2014, kanë kaluar dyfishin e kohëzgjatjes së rregullt të studimeve, kanë dëgjuar ligjëratat e vitit të fundit, si dhe kanë përfunduar të gjitha provimet e tri (3) viteve paraprake, u vazhdohet periudha e përfundimit të studimeve deri më 30.9.2024.
- IV. Studentëve të nivelit baçelor me sistem katër (4) vjeçar, të cilët i kanë regjistruar studimet para vitit akademik 2013/2014 dhe të cilët i kanë përfunduar të gjitha provimet në programet ku studimet përfundojnë me mbrojtje të temës së punimit të diplomës, u vazhdohet periudha e diplomimit, respektivisht mbrojtjes së temës së punimit të diplomës deri më 30.9.2024, ndërsa në programet ku studimet përfundojnë pa punim të diplomës dhe nuk kanë më shumë se dy provime të vitit të fundit, u vazhdohet periudha e përfundimit të studimeve deri më 30.9.2024.
- V. Studentëve të nivelit baçelor me sistem pesë (5) vjeçar, të cilët i kanë regjistruar studimet në vitin akademik 2010/11, kanë kaluar dyfishin e kohëzgjatjes së studimeve të rregullta, kanë dëgjuar ligjëratat e vitit të fundit të studimeve, si dhe kanë përfunduar të gjitha provimet e katër (4) viteve paraprake të studimeve, u vazhdohet periudha e përfundimit të studimeve deri më 30.9.2024.
- VI. Studentëve të nivelit baçelor me sistem pesë (5) vjeçar, të cilët i kanë regjistruar studimet para vitit 2011/2012 dhe të cilët i kanë përfunduar të gjitha provimet në programet ku studimet përfundojnë me mbrojtje të temës së punimit të diplomës, u vazhdohet periudha e diplomimit, respektivisht mbrojtjes së temës së punimit të diplomës deri më 30.9.2024, ndërsa në programet



ku studimet përfundojnë pa temë të punimit të diplomës dhe nuk kanë më shumë se dy provime të vitit të fundit, u vazhdohet periudha e përfundimit të studimeve deri më 30.9.2024.

- VII. Studentëve të nivelit master me sistem një (1) vjeçar të studimeve, të cilët i kanë regjistruar studimet në vitin akademik 2019/2020, kanë kaluar dyfishin e kohëzgjatjes së rregullt të studimeve dhe kanë dhënë 50% të provimeve të parapara, si dhe kanë paraqitur ndonjë provim gjatë vitit akademik 2022/2023, pa marrë parasysh rezultatet, u vazhdohet periudha e përfundimit të studimeve deri më 30.9.2024.
- VIII. Studentëve të nivelit master me sistem një (1) vjeçar të studimeve, të cilët i kanë regjistruar studimet para vitit akademik 2019/2020 dhe të cilët i kanë përfunduar të gjitha provimet, u vazhdohet periudha e diplomimit, respektivisht mbrojtjes së temës së diplomës deri më 30.9.2024.
- IX. Studentët e nivelit master me sistem dy (2) vjeçar të studimeve, të cilët i kanë regjistruar studimet në vitin akademik 2017/2018, kanë kaluar dyfishin e kohëzgjatjes së rregullt të studimeve dhe nëse kanë përfunduar provimet e vitit të parë, si dhe kanë paraqitur ndonjë provim gjatë vitit 2022/2023, pa marrë parasysh rezultatet, u vazhdohet periudha e përfundimit të studimeve deri më 30.9.2024.
- X. Studentëve të nivelit master me sistem dy (2) vjeçar të studimeve, të cilët i kanë regjistruar studimet para vitit akademik 2017/2018 dhe të cilët i kanë përfunduar të gjitha provimet, u vazhdohet periudha e diplomimit, respektivisht mbrojtjes së temës së diplomës deri më 30.9.2024.
- XI. Studentëve të nivelit baçelor dhe master që kanë kaluar dyfishin e kohëzgjatjes së rregullt të studimeve, kanë dëgjuar ligjëratat e vitit të fundit, mirëpo nuk i kanë përfunduar të gjitha provimet e parapara në programet në të cilat studimet përfundojnë me mbrojtje të temës së punimit të dipomës, ndërsa fakulteti përkatës nuk i ofron këto studime me programe të reja studimore, nuk u vazhdohet periudha e përfundimit të studimeve.
- XII. Afati i fundit për përfundimin e studimeve sipas parimit të pikës XI të këtij vendimi është përcaktuar me vendimet paraprake të Senatit.
- XIII. Studentëve të tjerë të nivelit të studimeve baçelor dhe master të cilët e kanë kaluar dyfishin e kohëzgjatjes së studimeve të rregullta për vit studimi, ndërsa aktualisht janë në vitin e parë (I), dytë (II), tretë (III), katër (IV) apo pestë (V), por që nuk kanë përfunduar provimet sipas kushteve të përcaktuara në pikat I deri X të këtij vendimi, u mundësohet vazhdimi i studimeve sipas plan-programit të ri të studimeve pa pasur nevojë aplikimi përmes konkursit publik.
- XIV. Studentët e nivelit të doktoratës të cilët kanë tejkaluar afatin e kohëzgjatjes së studimeve të përcaktuar sipas rregullores në fuqi në kohën e regjistrimit të studimeve, u vazhdohet periudha e mbrojtjes së punimit të doktoratës deri më 30.9.2024.
- XV. Periudha e suspendimit të përkohshëm të statusit të studentit të rregullt në bazë të dispozitave përkatëse të Statutit, nuk llogaritet në kohëzgjatjen e studimeve.



- XVI. Njësitë akademike obligohen që këtë vendim ta publikojnë në tabelat e shpalljeve në njësitë përkatëse akademike.
- XVII. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi shfuqizohet Vendimi me nr. prot. 3/201, datë 28.9.2022.
- XVIII. Përgjegjës për zbatimin e këtij vendimi janë menaxhmenti qendror i UP-së, njësitë përkatëse akademike dhe sekretari i përgjithshëm.
- XIX. Ky vendim do të vlejë për vitin akademik 2023/24. Pas përfundimit të vitit akademik 2023/2024, respektivisht pas datës 30.9.2024, nuk do të lejohet periudhë shtesë, respektivisht vazhdim i kohëzgjatjes së afatit për përfundimin e studimeve për kategoritë e studentëve në kuptim të dispozitave të këtij vendimi.
- XX. Përjashtimisht pikës XIV të këtij vendimi, nuk ju lejohet afat shtesë për përfundimin e studimeve studentëve të nivelit të doktoratës, të cilët e kanë kaluar dyfishin e kohëzgjatjes së rregullt të studimeve dhe kohën shtesë të lejuar me vendime paraprake të Senatit dhe kanë qenë joaktivë gjatë vitit akademik 2022/23.
- XXI. Ndërlidhur me çështjet e trajtuara dhe përcaktimet e këtij vendimi, obligohen njësitë akademike të bëjnë analizë empirike, respektivisht studim të përgjithshëm lidhur me problemet konkrete, me qëllim të identifikimit të zgjidhjeve, respektivisht propozimit të ndërmarrjes së masave specifike, për adresim në Senatin e UP-së, brenda një periudhe dy (2) mujore nga dita e marrjes së këtij vendimi.
- XXII. Obligohen Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina” dhe njësitë akademike të tij ta publikojnë vendimin në ueb faqet e tyre zyrtare dhe që përmes mënyrave më të përshtatshme të njoftimit, së paku dy herë gjatë vitit akademik 2023/24, respektivisht një njoftimi për semestër, t’i informojnë studentët lidhur me përmbajtjen dhe përcaktimet e këtij vendimi.
- XXIII. Ky vendim hyn në fuqi nga dita e miratimit në Senatin e UP-së.

**T’u dërgohet:**

1. Arkivit të UP-së;
2. Anëtarëve të Senatit;
3. Sekretarit të përgjithshëm të UP-së;
4. Dekanëve të njësive akademike;
5. Sekretarëve të njësive akademike;
6. Zyrës për çështje akademike;
7. Zyrës për shërbimin e studentëve.

